



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL
DREJTORIA JURIDIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Tiranë, më 14.5.2026

Njoftim për vende vakante në shërbimin civil në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural

Në zbatim të nenit 26, të ligjit 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe të Kreut II dhe III, të Vendimit nr. 242, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, në zbatim të pikës 9, të Vendimit nr. 719, datë 31.10.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”, i ndryshuar, të Urdhrit nr. 93, datë 12.6.2024, të Kryeministrit “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural”,

Departamenti i Administratës Publike ka shpallur procedurat e lëvizjes paralele, si dhe pranim në shërbimin civil:

- Për lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil 2 (dy) pozicione të lira:
 1. Inspektor në Sektorin e Autorizimit të Pagesave IPARD, për Masën 1, Masën 3, Masën 7 dhe Masën 9, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-1;
 2. Inspektor në Sektorin e Autorizimit të Pagesave IPARD, për Masën 4, Masën 5, Masën 6, Masën 10 dhe Masën 11, në Drejtorinë e Autorizimit të Pagesave, në Agjencinë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural, klasa e pagës IV-1.

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet/shfaq/7345>

Janë të ftuar të gjithë nëpunësit e interesuar, pjesë e shërbimit civil, si dhe kandidatët për pranim në shërbimin civil të aplikojnë për pozicionin vakant të shpallur. Në lidhjet përkatëse, mund të gjeni informacionin e plotë për kriteret, dokumentacionin, mënyrën dhe afatin e dorëzimit, si dhe përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin/et.

Për më shumë informacion ndiqni faqen zyrtare të Departamentit të Administratës Publike në lidhjen:

<https://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>

AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL